



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE RAJONALE BERAT

NJESIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Berat , më _____._____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “**Materiale Konsumi Mjekësor me 3 (tre) Lote MM1, MM2 dhe solucione pastrimi**” për një periudhë 12 (dymbëdhjete) mujore”- *Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Materiale Mjekësore të konsumueshme : 33140000-3

Fondi limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër: 18,717,379

(tetëmbëdhjete milion e shtatëqind e shtatëmbëdhjete mijë e treqind e shtatëdhjete e nente) Lekë pa TVSH.

Loti 1 “ MM1-Materiale Mjekimi të Përgjithëshme” me fond limit 8,910,253 (tetëmilion e nëntëqind e dhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë tre) lekë pa tvsh,

Loti 2 “MM2-Materiale Mjekimi Konsumi dhe Kirurgjikale” me fond limit 9,682,543 (nëntëmilion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e dyzetë e tre) lekë pa tvsh.

Loti 3 “Blerje Solucion pastrimi dhe solucion dizifektimi për endoskopet” me fond limit 124,583 (njëqind e njëzetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) leke pa tvsh.

Fondi limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër: 191,013.15 (njëqind e nente dhjete e nje mije e trembedhjetepike pesembedhjete) Euro pa TVSH sipas kursit kombetare te **BSH me 97.99 date 16.06.2025** dhe sipas loteve:

Loti 1 “ MM1-Materiale Mjekimi të Përgjithëshme” me fond limit 90,930.23 (nentedhjete mije nenteqind e tridhjete pike njezete e tre) Euro pa tvsh,

Loti 2 “MM2-Materiale Mjekimi Konsumi dhe Kirurgjikale” me fond limit 98,811.54 (nëntëdhjete e tetemije e teteqind e njembedhjete pike pesedhjete e kater) Euro pa tvsh.

Loti 3 “Blerje Solucion pastrimi dhe solucion dizifektimi për endoskopet” me fond limit 1,271.38(njëmije e dyqind e shtatedhjete e nje pike tridhjete e tete) Euro pa tvsh.

Lloji i procedurës së prokurimit është: **E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR – mallra.**

Lloji i procedurës është përzgjedhur në zbatim të nenit 42, pika 2, të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe VKM nr. 285 ,datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 47.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 74, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar specialisti i fushes ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PER TE TRE LOTET

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a) *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 82 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe VKM-ja Nr.285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik “, i ndryshuar , neni 26, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 82: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

b) *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Lot no.	Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës per cdo lot, në Leke pa TVSH	Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës per cdo lot, në EURO pa TVSH
Lot 1	178,205.06 leke (nje qind e shtate dhjete e tetemije e dyqind e pese pike zerogjashte)	1,818.6 Euro
Lot 2	193,650.86 leke(nje qind e nentedhjete e tre mije e gjashteqind e pesedhjete pike tetedhjetee gjashte)	1,976.23 euro
Lot3	Vlera e fondit limit eshte poshte vleres se blerjeve me vlere te vogel dhe per kete rrjedhoje nuk kerkohet.	Vlera e fondit limit eshte poshte vleres se blerjeve me vlere te vogel dhe per kete

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ,ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë :

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

.....
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të

paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare të fundit nga data e hapjes së ofertave: 2022; 2023; 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të

jetë jo më e vogël se 20% e fondit limit për secilin lot për të cilin oferton të kësaj Proçedure Prokurimi.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar, konkretisht mbi vlerën e përcaktuar në pikën 2.10. /ose/ 2.14

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera e xhiros minimale do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto

DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar: në nenin 43 pika 2/a dhe pika 4, 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/a

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur

nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik :

2.3.1. Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit të lotit/lotëve që OE Oferton dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një autoritet / ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose/ dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për secilin lot që oferton këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 / 2.14. Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera prej 20 % do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 4 të nent 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilën gjejmë se : pika 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Ne baze të VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, pika 4 ku citohet se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për aftësinë e tyre teknike nepermjet përvojave të duhura që janë në përpjestim me natyrën e objektit të prokurimit për zbatimin e kontratës. Për këtë është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën 1 të DST)

Argumentimi: (Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në të cilën është përcaktuar: Pika 8 ” Autoriteti/enti kontraktor ,përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen ,mund të përcaktojë kritere të vecanta në varësi të objektit që prokurohet ,të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës ” dhe kësaj kërkesë i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi).

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent, ose ISO 13485 ”Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjeksore”, /ose ekuivalent/, të vlefshme, për prodhuesin/të artikujve të ofruar ose ofertuesi të paraqesë një vetëdeklarim që furnizuesi është konform standardeve të cilësisë, dhe AK të rezervojë të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit si dhe në rastin kur OE shpallet fitues, AK të kërkojë paraqitjen e certifikatës në fjalë.

Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikata të jetë brenda afatit të vlefshmërisë, në gjuhën shqip, anglisht ose të përkthyer dhe të noterizuara.

Shenim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave/në raport me përqindjen e pjesëmarrjes që merr përsipër të realizojë sipas kontratës së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nën 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Si dhe ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, ia kredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001 /ose/ ekuivalent ISO 13485 ”Per Sistemin e menaxhimit te cilesise” /ose ekuivalent/ të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë.

Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shenim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave/ne raport me përqindjen e pjesëmarrjesqë merr përsipër të realizojë sipas kontrates se bashkepunimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe*

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Si dhe ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, ia kredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE ose FDA sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik", në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ I vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Si dhe në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ I vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar për periudhën 2025-2026.

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 5 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku është e caktuar: Pika 5. "Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në

mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. (e vlefshme vetëm për OE lokalë/vendas) .

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Gjithashtu ky kriter është bazuar dhe në nenin 21, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

2.3.8 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vertetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pikë 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

2.3.9 Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Qendres Spitalore Rajonale Berat, të mbyllura me ngjithëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit : Materiale Konsumi Mjekësor me 3 (tre) Lote MM1, MM2 dhe solucione pastrimi” për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) muajore”- Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”. dhe jo para datës 18.07.2025, ora 12:00.

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 1).
- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 1).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vertetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 a) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kekojë operatoreve ekonomik të dorezojnë deshmi, që tregojnë se ato i plotësojnë kërkesat minimale, të percaktuara në dokumentet e tenderitsi:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.³⁸ Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar me mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për materialet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e percaktuara nga AK. Materialet e kërkuara janë të një rëndësie të vecantë për sa i përket dhenies së shërbimit ndaj pacientave pasi janë materialet baze për spitalin. Është shumë e rëndësishme vlerësimi dhe testimi fizik i mostrave në mënyrë që AK të sigurohet që do të furnizohet me materiale cilësore dhe konform kërkesave. AK gjykon se nuk mund të bazohen vetëm në kataloget apo certifikatat e cilësive për të bërë një vlerësim sa më të saktë pasi në shumë raste ndodh që materialet janë të një cilësie nga materialet e treguara në katalog. Gjithashtu paraqitja e mostrave i shërben AK për të vertetuar që cdo permase e paraqitur në katalog është e realizueshme edhe në prodhim cka i jep siguri AK që nuk do të furnizohet me cdo material dhe permase të kërkuara. Nga procedurat e zhvilluara ndër vite për të njëjtin objekt, ka rezultuar që paraqitja e mostrave e ka ndihmuar AK të bëjë një vlerësim më të saktë dhe të furnizohet me materiale cilësore konform kërkesave dhe që garantojnë një trajtim sa më cilësor për pacientet.

Shënim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Loti 1 “MM1-Materiale Mjekimi të Përgjithëshme”

Nr	Artikulli	Specifikime teknike	Njësia	Sasia per 12 muaj
----	-----------	---------------------	--------	-------------------

Garza, Bende, te tjera konsumable te pergjithshme				
2	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë	7500
3	Bende elastike 7.5cm x 4m	100% pambuk elastik, pesha 80-90g/cm2	Copë	1600
4	Bende allcie 10cm x 2.7m	Paketimi individual plastic	Copë	600
5	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitese e mbrojtur me leter te shqiteshme	Copë	270
6	Bende 20 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë	12000
7	Bende allcie 15cm x 2.7m	Paketimi individual plastic	Copë	1800
10	Komprese sterile 5cm x 5cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 6pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë	100
11	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë	10
14	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 16pala; paketim individual (1 cope/pako)	Copë	10
17	Hemostatik kolageni i absorbueshem	Siperfaqe 100-110 cm2, me origjine nga tendinet e kuajve, 2.8 mg/cm2 fibrile kolageni ose ekuivalent	Copë	20
18	Garze abdominale	Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensionit i nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde te qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako	Copë	4500
19	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	m. linear	1200
21	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofil, pakete 100g	Copë	4000

22	Pulla injeksioni	Dimensionet e peraferta: 0.9 cm x 3.8 cm , me garze perthithese ne mes dhe dy anet me ngjites antialergjik	Copë	2000
23	Leukoplast 5cm x 5m	cope 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu	Copë	4250
25	Vaj instrumentash	Vaj per mbrojtjen e endoskopeve dhe instrumentave kirurgjikale qe kane pjese te levizshme. Perdoret pas pastrimit dhe para procesit te sterilizimit. Shishe max. 50-100ml ose ekuivalent	Copë	5
26	Solucion pastrimi per optike	Per pastrimin e lenteve, siperfaqeve optike dhe fibrave optike te endoskopeve. Tubet 4-5 gram.	Copë	50
	Sisteme dhe doreza			
27	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishet edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer luck + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP flow rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .	Copë	150000
28	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile , me latex natyral , me puder , me permasa XS, S, M, L.	Copë	150000
29	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5	pale	34000
30	Lama bisturie	Nr: 15, 20, 21, 22, 23, 24	Copë	4400
Materiale konsumi per respirim, aspirim, infuzion				
31	Filter baktericid	per respirim artificial, antibakterial, HMEF	Copë	5
32	Qarqe respiratori	per respirim artificial L= 1.5 m; ID 22 mm	Copë	5

35	Maske oksigjeni	me zgjatues L=1.5-2m	Copë	180
36	Sonde oksigjeni adult	nazale, adult, L=1.5-2 m	Copë	1000
37	Sonde oksigjeni pediatrike	nazale, pediatrike L=1.6+0.6 m, diam .4 mm	Copë	20
38	Kanjula nazale per CPAP	Per infant, ne permasa te ndryshme dhe tipologji sipas autoritetit kontraktor	Copë	50
39	Komplet aerosoli me tub zgajtues 1.5m	maske me rezervuar per medikamente	komplet	5
42	Dren pleural	Tip trocar me brima anash	Copë	10
44	Dren Kehr	silikon, Ch 10-14-16-18-20	Copë	10
45	Tub drenimi	silikon, rulon 20-30m, diam. 6-8mm dhe 8-10mm	meter	120
46	Tub drenimi penrose	100% silicon transparent, opak x-ray, gjeresia 20, 25, 35mm , L=40-50cm.	Copë	30
49	Dren me troakar	Ch12-Ch20	Copë	15
50	Pleurovac me regullator tub zgjates me varse per krevat	3-chambers, tub zgjatues silikoni 1.8-2m, vellimi mbi 2100-2500ml, pajisur me rregullatore te integruar presioni dhe lageshtie dhe valvol sigurie	Copë	1
58	Maske per terapi CPAP	Madhesi e adoptueshme nga masa S deri ne L	Copë	20
66	Set tubimi histeroskopik, steril	Per irrigim te drejtuar, me dy age punkcioni, me membrane per monitorim te presionit te irrigimit.	set	10
70	Kateter epidural	kateter 19G/20G+age epidurale+filter	Copë	10

71	Set epidural	kateter 19G/20G+age epidurale+gide +filter+ shiringe	set	10
72	Kateter venoz Seldinger 2-ruges	me dy ruge, tip Seldinger, L=20-30cm	Copë	10
75	Aparat klizme adult		Copë	50
77	Kapese kordoni umbilikal		Copë	600
80	Zhgute		Copë	400
